VENDIM
Nr.160, datë 2.3.2011

PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË FINANCIMIT, NË BUXHETIN E VITIT 2011, PËR BASHKËSITË FETARE QË KANË NËNSHKRUAR MARRËVESHJE ME KËSHILLIN E MINISTRAVE

(Ndryshuar me VKM nr. 849, datë 14.12.2011)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.10 140, datë 15.5.2009 "Për financimin nga Buxheti i Shtetit të bashkësive fetare që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave", të nenit 5 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 "Për buxhetin e vitit 2011", me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shuma prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh, e miratuar për financimin e bashkësive fetare, në buxhetin e vitit 2011, të përdoret sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, e sipas ndarjes së mëposhtme:

a) Komuniteti Mysliman i Shqipërisë përfiton *30 478 175 (tridhjetë milionë e katërqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë*, të ndarë, si më poshtë vijon:

i. *15 604 175 (pesëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e katër mijë e njëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë*, për financimin deri në gjysmën e pagës minimale buxhetore për punonjësit e administratës;

ii. 10 374 000 (dhjetë milionë e treqind e shtatëdhjetë e katër mijë) lekë, për financimin, për pagat e arsimtarëve të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar;

iii. 4 500 000 (katër milionë e pesëqind mijë) lekë për ndërtimin e për mirëmbajtjen e objekteve të kultit, në Bajram Curri, Tropojë, Shupenzë, Çermë, Roshnik etj.

b) Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë përfiton shumën *26 158 675 (njëzet e gjashtë milionë e njëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë*, të ndarë, si më poshtë vijon:

i. *21 598 675 (njëzet e një milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë* për financimin deri në gjysmën e pagës minimale buxhetore për punonjësit e administratës;

ii. 4 560 000 (katër milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë për financimin për pagat e arsimtarëve të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar.

c) Kisha Katolike në Shqipëri përfiton shumën *25 816 675 (njëzet e pesë milionë e tetëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë*, të ndarë, si më poshtë vijon:

i. *4 270 675 (katër milionë e dyqind e shtatëdhjetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë* për financimin deri në gjysmën e pagës minimale buxhetore, për punonjësit e

administratës;

ii. 21 546 000 (njëzet e një milionë e pesëqind e dyzet e gjashtë mijë) lekë për financimin për pagat e arsimtarëve të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar.

ç) Kryegjyshata Botërore Bektashiane përfiton shumën *17 546 475 (shtatëmbëdhjetë milionë e pesëqind e dyzet e gjashtë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë*, të ndarë, si më poshtë vijon:

i. *2 693 975 (dy milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë* për financimin deri në gjysmën e pagës minimale buxhetore për punonjësit e administratës;

ii. *10 852 500 (dhjetë milionë e tetëqind e pesëdhjetë e dy mijë e pesëqind) lekë* për ndërtimin e për mirëmbajtjen e objekteve të kultit "Odeoni";

iii. 4 000 000 (katër milionë) lekë, për shkak të pozitës së veçantë, si Kryegjyshatë Botërore me qendër në Tiranë, dhe të shtrirjes së veprimtarisë së saj jashtë vendit.

2. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Financave dhe Komiteti Shtetëror për Kultet për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

I. Komuniteti Mysliman i Shqipërisë me shumën 31,632,000 lekësh të ndarë si më poshtë:

1. Mbështetje për fondin e pagave të personelit në shumën 16,758,000 lekë për 147 punonjës.

2. Mbështetje për pagat e arsimtarëve në shumën 10,374,000 lekë për 91 arsimtarë.

3. Për rikonstruksion dhe mirëmbajtjen e objekteve të kultit në shumën 4,500,000 lekë për objektet e mëposhtme:

i) Xhamia e Bajram Currit 3,960,000 lekë

ii) Xhamia Shupenzë 540,000 lekë

II. Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë me shumën 26,220,000 lekë, të ndarë si më poshtë:

1. Mbështetje për fondin e pagave të personelit në shumën 21,660,000 lekë për 190 punonjës.

2. Mbështetje për pagat e arsimtarëve në shumën 4,560,000 lekë për 40 arsimtarë.

III. Kisha katolike me shumën prej 25,878,000 lekë, të ndarë si më poshtë:

1. Mbështetje për fondin e pagave të personelit në shumën 4,332,000 lekë për 38 punonjës.

2. Mbështetje për pagat e arsimtarëve në shumën 21,546,000 lekë për 189 arsimtarë.

IV. Kryegjyshata Botërore Bektashiane me shumën 16,270,000 lekë, të ndarë si më poshtë:

1. Mbështetje për fondin e pagave të personelit në shumën 3,762,000 lekë për 33 punonjës.

2. Për rikonstruksion e mirëmbajtje të objekteve të kultit në shumën 8,508,000 lekë

për objektin “Odeon”.

3. Për Kryegjyshatën Botërore si kryeqendër, për veprimtari ndërkombëtare, në shumën 4,000,000 lekë, të ndarë si më poshtë:

i) Veprimtaria ndërkombëtare në shumën prej 2,000,000 lekësh.

a) veprimtaria për 20-vjetorin e rihapjes së Kryegjyshatës Botërore Bektashiane dhe 80-vjetori i vendosjes së saj në Shqipëri, e cila do të mbahet në Tiranë në mars 2011, me shumën 1,451,000 lekë;

b) veprimtaria për pjesëmarrje në pelegrinazhin e Haxhi Bektashit, Turqi, me shumën 549,000 lekë.

ii) Për udhëtime e pritje të Kryegjyshatës Botërore në gjyshatat dhe institucionet bektashiane që ndodhen në vende të tjera, si: SHBA, Maqedoni, Kosovë, Turqi, Egjipt, Bullgari, Greqi, Hungari, Francë etj., shumën 2,000,000 lekë.